



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26.6.2023

Nr: 670

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË BELSH, QARKU ELBASAN, Z. ARIF FAIK TAFANI, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 26.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Belsh, Qarku Elbasan, z. Arif Faik Tafani të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**VËREJ:**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Bazuar në nenin 33, shkronja "g", Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 45, me vendimin nr. 157, datë 17.5.2023, ka shpallur fitues z. Arif Faik Tafani, si Kryetar i Bashkisë Belsh, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Data: 26.6.2023 Nr: 670  
Ora: 14:00



"Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Belsh, Qarku Elbasan, z. Arif Faik Tafani, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Kundër këtij vendimi u administrua kërkesa ankimore nr. 76, datë 22.05.2023, me ankues Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt:

- kundërshtimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”;
- rinumërim dhe rivlerësim të votave në të gjitha qendrat e votimit, si dhe Miratimi i Tabelës së Re Përmbledhëse për zonën zgjedhore Belsh;
- pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë;
- ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkie Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e QV nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë;
- si dhe shpalljen fitues për kryetar z. Bedri Qypi.

KAS, në seancën e shqyrtimit më datë 06.06.2023, ora 18:00 vendosi:

1. *Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore nr. 76, datë 22.05.2023 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.*
2. *Ndryshimin e vendimit nr. 533, datë 18.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, sipas tabelës përmbledhëse të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS të datës 06.06.2023.*
3. *Rrëzimin e kërkesës për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë.*

Kundër vendimit të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve nr. 175, datë 6.6.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 76, datë 22.05.2023 të depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja nr. 30 Regj. Themeltar, datë 09.06.2023, me ankues Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt:

- Ndryshimin e vendimit nr. 175, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

1. Rinumërimin dhe rivlerësimin e drejtë të votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i drejtë i votave;

2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;
3. Ndryshimin e Vendimit të KSHZ nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj 2023”, duke pasqyruar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë; si dhe
4. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Më datë 15.6.2023, ora 15:30, në përfundim të seancës së shqyrtimit, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me vendimin nr. 29, vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S:**

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Belsh, Qarku Elbasan, z. Arif Faik Tafani, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**